



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief  
State Prosecutor**

**A.nr. 265/2014  
Prishtinë me dt.03.12.2014**

Pas mbajtjes së konsultimeve në kolegiumin e Prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të nenit 44 të KPPK, më 03.12.2014 lëshoi këtë

**UDHËZIM**

I.Kryeprokurori i Zyrës Prokuroriale vendos mbi kërkesën për përjashtimin e Prokurorit të Shtetit të Zyrës së tij.

II.Kryeprokurori i Apelit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore ose mbi kërkesën për përjashtimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore dhe Prokurorit të Shtetit të së njëjtës prokurori.

III.Ky Udhëzim dërgohet të gjithë Kryeprokurorëve të prokurorive themelore, të Kryeprokurorit të Apelit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

**Arsyetim**

Gjatë punës praktike të Zyrëve Prokuroriale janë paraqitur paqartësi e dilema lidhur me atë se kush vendos për përjashtimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore dhe në këtë drejtim imponohet nevoja që të bëhet interpretimi i saktë dhe zbatimi i drejtë i dispozitës së nenit 44 par.3 të KPPK.

Dispozitat e KPPK decidivisht nuk parashohin mundësinë që pala të kërkon përjashtimin e Prokurorit të Shtetit. Kështu, neni 44 i KPPK jep me kuptu se iniciativa për përjashtimin e një prokurori të Shtetit duhet të rrjedh nga vet prokurori i shtetit siç decidivisht thuhet në paragrafin 2 të këtij Kodi.

Mirëpo, me interpretimin e gjerë të par.3 të Kodit rezulton se iniciativa (kërkesa) për përjashtimin e prokurorit të shtetit mund të paraqitet edhe prej të tjerëve, respektivisht prej atyre që kanë interes juridik për këtë. Kështu, në fjalinë e parë të par.3 të Kodit

thuhet se prokurori i shtetit mund të kundërshton përjashtimin e tij dhe të kërkon që lidhur me kërkesën e tij të vendos prokurori i shtetit më i lartë. Është plotësisht e pakuptueshme që prokurori i shtetit që ka mësuar se ekzistojnë kushtet për përjashtimin e tij dhe që ka kërkuar përjashtimin e tij, tani të kundërshton kërkesën për përjashtimin e tij nga pala tjetër. Prandaj me të drejtë rezulton se pala ka të drejtë të paraqet kërkesë për përjashtimin e prokurorit të shtetit. Për ndryshe personat që kanë interes juridik për përjashtimin e Prokurorit të Shtetit janë palët : i pandehuri dhe i dëmtuari dhe në këtë drejtim kërkesat e tyre duhet të vlerësohen si të lejuara.

Në fjalinë e dytë të par.3 të nenit 44 të KPPK parashihen dy instanca më të larta se Prokurori i Shtetit dhe ato janë : Kryeprokurori i një Zyreje dhe Kryeprokurori i Shtetit. Sipas kësaj fjali rezulton se kur një Prokuror Shtetit kundërshton kërkesën e palës për përjashtimin e tij, për këtë vendos Kryeprokurori i Zyrës në të cilën e ushtron detyrën e Prokurorit të Shtetit. Mirëpo, kur ky Prokuror i Shtetit që ka kundërshtuar përjashtimin e tij dhe për të cilën Kryeprokurori i Zyrës së tij e ka aprovuar kërkesën për përjashtimin e tij, atëherë ai ka të drejtë të ankohet Kryeprokurorit të Shtetit, sepse Kryeprokurori i Shtetit, sipas fjalisë së dytë të par.3 të KPPK , jep vendimin përfundimtar mbi përjashtimin e një prokurori të shtetit. Pra sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se kundër vendimit të Kryeprokurorit të Zyrës mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit të shtetit, mund të ushtrohet ankesë Kryeprokurorit të Shtetit, i cili jep vendimin përfundimtar. Në fjalinë e tretë të par.3 të nenit 44 të KPPK thuhet se vendimet duhet të jenë të shkruara dhe ato i dërgohen Prokurorit që ka kundërshtuar përjashtimin e tij dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Edhe sipas kësaj fjalie rezulton se Prokurori për përjashtimin e të cilit është vendosur, ka të drejtë ankese Kryeprokurorit të Shtetit.

Mirëpo kjo dispozitë ligjore ( par.3 i nenit 44 të KPPK) në një farë mënyre është në kundërshtim me vetveten sepse me këtë dispozitë ipet mundësia që të përjashtohet një hallkë e rëndësishme e sistemit prokuroria e ajo është Prokuroria e Apelit.

Sipas ligjit për Prokurorinë e Shtetit, Prokuroria e Apelit është Prokurori drejtpërdrejt më e lartë në raport me Prokuroritë Themelore. Prandaj kur një prokuror shteti në zyrën e një Prokurorie Themelore kundërshton përjashtimin e tij, vendos Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore ndërsa kur një Kryeprokuror i një Prokurorie Themelore kundërshton përjashtimin e tij, vendos Kryeprokurori i Apelit si Prokuror më i lartë e kjo në pajtim me fjalinë e parë të par.3 të nenit 44 të KPPK. Njëherit kjo zgjidhje ligjore duhet të interpretohet përshtatëshmërishtë edhe sipas dispozitave ligjore që flasin për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore, pasi që Prokuroria e Apelit vepron pranë Gjykatës së Apelit dhe kjo Prokurori në raport me Prokurorinë Themelore është organ i shkallës së dytë.

Poashtu, konsiderohet se prokurori i një Prokurorie Themelore e kundërshton përjashtimin e tij edhe në situatën kur pranon një kërkesë (prej palës)për përjashtimin e tij dhe atë kërkesë ia dërgon Kryeprokurorit të Zyrës së tij apo kur një kërkesë e tillë për përjashtimin e një Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore , Kryeprokurori i kësaj Prokurorie ia dërgon për vendosje Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.

**UD. I KRYEPROKURORIT TË SHTESTIT**

